REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 360
Data/Datum 18. 11. 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 29.07.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Sabri Xhigoli - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa dhe Ylber Kelmendi - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport.

Të tjerë: Stafi mbështetës i Kuvendit të Komunës.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë Kosovës e datës 27.04.2026.
2. Propozim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Propozim për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.
4. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar - Qershor 2026.
5. Propozim për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar- Qershor 2026.
6. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026.
7. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim, po ashtu sqaroi se janë edhe dy pika shtesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për arsyeshmërinë e të cilave do të jepen sqarime tjera shtesë nga Drejtorët e këtyre Drejtorateve.

Drejtori për Shërbime Publike: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Arsyeja e propozimit tonë për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, është se këto mjete financiare janë nga granti qeveritarë dhe nuk mund të shpenzohen për rrethojën e varrezave, andaj propozojmë që të shpenzohen për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve në qytet dhe fshatra të komunës, sepse kërkesat e qytetarëve janë të mëdha, këtu propozojmë të shpenzohen dy qind mijë euro, ndërsa në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të shpenzohet shuma prej një qind mijë euro,

ju ftoi që ta përkrahni këtë propozim, në mënyrë që mjete financiare të mos kalojnë në suficit në fund të vitit.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozimi ynë është që ta caktojmë lokacionin për ndërtimin e stadiumit të atletikës në sipërfaqe prej 2.12 ha, në fshatin Miradi e Poshtme, në bazë të kërkesës së Federatës së Atletikës së Kosovës, ky stadium do të ndërtohet sipas standardeve të Federatës Evropiane të Atletikës dhe do të shërben, edhe për Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030', aty është ndërtuar edhe Palestra e Gjimnastikës, andaj ju ftoi ta përkrahni të gjithë.

Filloreta Musaj: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim rendin e ditës dhe dy pikat shtesë pas dëgjimit të arsyetimeve të Drejtorëve të Drejtorateve përkatëse për pikat në fjalë.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani pikat shtesë nuk janë në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, kërkesa e Federatës së Atletikës së Kosovës, ka ardhur me kohë, ndërsa propozimi është bërë me vonesë, ne për arsye të rëndësisë së saj e përkrahim, por jo edhe formën e paraqitur. Ridestinimi i buxhetit të komunës për vitin 2026, i parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, secila prekje në buxhet është në fakt rishikim i buxhetit, kjo punë nuk lejohet në këtë formë, pse po tentohet të largohet kodi për rrethojën e varrezave, pse nuk po e ndryshoni buxhetin krejt. Kërkoi sqarime nga Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me një ridestinim të buxhetit, brenda programit të njëjtë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për arsye të realizimit efektiv të buxhetit brenda vitit buxhetor, në të kundërtën këto mjete financiare mund të kalojnë në suficit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ardhja e këtyre dy pikave e ka arsyshmërinë e vetë, ridestinimi i buxhetit është brenda programit buxhetor, kërkohet vetëm ndërrimi i destinimit të tyre, ju për njëzet e pesë vjet nuk e keni bërë rrethojën e këtyre varrezave, madje është propozuar rrethoja e varrezave në rrugën 'Reçica', por kjo nuk është realizuar, andaj propozojmë që këto mjete financiare të ridestinohen për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve, ku nevojat janë më të mëdha tani.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tek propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në fshatin Sllatinë e Vogël ka shumë nevojë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, ndërsa sa i përket lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës, a keni biseduar me qytetarët atje.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Kërkesa është e parashtruar me datën 18.06.2026, këtu unë kërkoi që ta kemi një mirëkuptim dhe ta bëjmë caktimin e lokacionit, në mënyrë që të procedojmë me realizimin e këtij projekti me rëndësi për sportin.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë jam dakort me rendin e ditës, por jo edhe me dy pikat shtesë që janë sjellur jashtë Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, ju e dini kronologjinë e hapjes së kodit për varreza në Fushë-Kosovë dhe fshatin Miradi e Epërme, ku unë edhe buxhetin e komunës e kam votuar me këtë kusht, pastaj ky kod është mbyllur me vonë pa realizimin e projektit në fjalë, nevoja për caktimin e lokacioneve për varreza në Fushë-Kosovë dhe Sllatinë të Madhe, pas caktimit të lokacioneve, duhet të bëhet edhe gardhimi i tyre, ju nuk duhet ta mbyllni këtë kod në buxhetin e komunës. Ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa keni qenë në

opozitë asnjëherë nuk i keni votuar pikat shtesë, për caktimin e lokacionit për Stadiumin e Atletikës, a keni mbajtur diskutim publik me banorët e fshatit, të cilin ju e kërkonit në secilin rast sa keni qenë në opozitë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo më shumë është çështje e perceptimit, këtu kemi të bëjmë me ndërtimin e rrethojave të varrezave, jo blerjen e pronës për varreza, u sqarua shumë qartë nga dy Drejtorët e respektuar rëndësia e këtyre dy pikave, ka shumë nevojë për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve nëpër fshatra të komunës dhe në qytet.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovuan për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.

U votua me: tre vota 'për', një vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovuan për shqyrtim në mbledhjen e sotme 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës me dy pikat shtesë: Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026 dhe Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

U votua me: tre vota 'për', një vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovuan për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës me dy pika shtesë: Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026 dhe Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 29.06.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 29.06.2026'. Hap diskutimin.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.06.2026'.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, janë arsyet tona, pse nuk mund ta votojmë këtë ekstrakt të procesverbalit, sikur audio-incizimit.
Dardane Sogojeva Shala: Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, sepse nuk po bëhen audio-incizimit e mbledhjeve, po mungon llogaridhënia.
Ali Ismaili: Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, sepse nuk po bëhen audio-incizimit e mbledhjeve, po mungon llogaridhënia.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 29.06.2026', me përmirësime.
U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 29.06.2026'.

Pika e dytë (2) - Propozim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky propozim është për kolegun tonë z. Gjelbrim Halili, anëtarë i kuvendit ta plotësoj Komitetin për Politikë dhe Financa, nëse nuk keni diskutim e qesim në votim.
U votua me unanimitet nga të pranishmit në mbledhje, gjithsej gjashtë anëtarë.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e aprovuan për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e Propozimit për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarin e ri: z. Xhelbrim Halili nga partia Aleanca.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime.
Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani në lidhje me Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore, kjo punë është një domosdoshmëri, sepse në arsim kemi shumë nevojë për norma të reja, këtu ideja është që shtatëmbëdhjetë vende të punës nga Administrata Komunale të barten tani për tani në arsim, ku nevojat janë shumë të mëdha, sepse kemi nevojë për së paku njëzet e gjashtë vende të punës të reja dhe zëvendësime, në fillim të muajit shtator, këtu ne e kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe votën për këtë propozim. Sipas vlerësimeve tona në arsim nevojiten edhe 140 norma të reja, edhe për pozicione tjera: pedagog, psikolog, por ne kemi shkuar këtu vetëm me vendet e punës bazë për mësimdhënës, deri te kjo situatë kemi ardhur për arsye të planifikimit jo të duhur, andaj tani duhet të ballafaqohemi me gjendjen reale ekzistuese dhe të kërkojmë zgjidhje.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore'.

Laureat Gojnovci: Ky problem është evident, është për tu vlerësuar tentativa për t'i bërë zgjidhje nxënësve, por kjo mënyrë po e vlerësojmë që nuk është në rregull, është e paprecedent nuk dihet opinioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk mund të bëhen ndryshime në punësime pa u mbështetur në Qarkore Buxhetore, vendet e punës në administratë, arsim dhe shëndetësi, i cakton Ministria e Financave, jo ne me vendim të Kuvendit të Komunës. As në kuadër të Administratës Komunale nuk ka mjaftueshëm punëtorë, këtu zgjidhja duhet të kërkohet nga Ministria e Arsimit, e jo të veprohet kështu në mënyrë parciale.

Dardane Sogojeva Shala: Ne e dijmë se ka nevojë për mësimdhënës të ri dhe se kemi problem të vazhdueshme në arsim, ka punëtorë arsimorë dhe punëtorë teknikë, që janë një vitë jashtë sistemit të pagave, pra nuk marrin paga fare, edhe për ata punëtorë, duhet të bëhet një zgjidhje. Ne mendojmë se arsimi ka nevojë më shumë për norma dhe vende të punës, se sa komuna dhe duhet të kërkojmë zgjidhje nga Ministria e Arsimit.

Ali Ismaili: Kësaj pike po i mungon elaborimi pak më i detajuar, tani ne e dijmë se Drejtori i Arsimit z. Sabri Xhigoli e ka marrë detyrën tani dhe i ka të trashëguara të gjitha problemet në arsim, drejtori e ka një përvojë të madhe në arsim, i njeh mirë rrethanat dhe besojmë, se do të punon mirë, por këto punë janë si në ajër, pa buxhet, duhet të na pranohen me buxhet një numër i konsiderueshëm i vendeve të punës në arsim, për këtë punë, presioni duhet të shtohet në Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave. Ne nuk e kemi të qartë, a kemi me marrë këtu mësimdhënës klasor apo për lëndë të caktuara, propozimi është dashur ta ketë edhe këtë pjesë të sqarimeve.

Drejtori për Arsim: Një pjesë e punëtorëve teknikë, është duke u shqyrtuar mundësia që të kalojnë tek Ndërmarrja Publike Lokale 'Fushë-Kosova'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Norma janë dhënë edhe në të kaluarën gjithsej 156 në arsim, por edhe kur janë dhënë ato nuk janë përdorë vetëm për arsim nga ish/pushteti.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Prej gjithsej 80 normave, për arsim janë vetëm 50 norma me buxhet, adnaj jemi të detyruar që ta provojmë realizimin edhe në këtë mënyrë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore' me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore'.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar- Qershor 2026, tani e ftoj Drejtorin për Buxhet dhe Financa të na paraqet përmbajtjen e materialit.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Raportin Financiar e keni marrë të gjithë, buxheti i aprovuar në Kuvendin e Komunës ka qenë 26,803,585.00€, me bartjen e të hyrave e cila ka ndodhur janë bartur edhe 4,006,082.00€, pra buxheti është rritur në vlerë 30,819,947.00€. Në periudhën e gjashtë mujorit të parë janë alokuar 23,353,442.00€, ndërsa janë shpenzuar 9,108,119.00€, shpenzimi total gjatë kësaj periudhe është 39%, me alokim, për paga dhe mëditje është shpenzuar 54%, për mallëra dhe shërbime 55%, për komunali 72%, ndërsa për kapitale janë shpenzuar 581,000.00€, ose 10.56%.

Filloreta Musaj: Pajtohemi më këtë shpenzime dhe jemi dakort që kjo pikë e rendit të ditës, të procedohet për shqyrtim dhe analizim edhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Kjo pikë e rendit të ditës, mund të elaborohet por nuk mund të arsyetohet, i keni rritur mallërat dhe shërbimet, në krahasim me vitin 2025, ndërsa në investime kapitale, shpenzimet janë vetëm 10% në gjashtëmujorin e parë, këtu shumica e buxhetit do të kalon në suficitë. Kjo punë është duke ndodhur, sepse ju nuk po merreni me punët që ju takojnë, realizimin e projekteve kapitale në teren, por po merreni po thuaj se çdo ditë me stafin e komunës.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Deri në muajin mars nuk ka patur buxhet, ju e dini mirë këtë punë, këto shpenzime janë realizuar shumica në tremujorin e dytë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' një abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim, nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e proceduan për shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin dhe analizimin e 'Propozimit për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026'.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Propozimin për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026, është informatë e përgjithshme, materialin e keni pranuar, andaj po e hapim diskutimin.

Filloreta Musaj: Nuk kemi të shtojmë, të gjitha shënimet janë pjesë e raportit të punës së Kuvendit, për këtë periudhë raportuese me sqarime për procesin e vendimarrjes së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Sa i përket punës së raportit të Kuvendit, ajo që e ka karakterizuar këtë Kuvend, gjatë këtyre muajve është mbarëvajtja jo e rregullt për arsye të sjelljes jo korrekte nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Ky Kuvend ka marrë vendime që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pyetja është sa vendime janë kthyer në rishqyrtim, sa prej tyre janë trajtuar dhe sa prej tyre janë të publikuar në ueb-faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mbarëvajtja e punës së Kuvendit të Komunës është realizuar në përputhje me rregullat dhe procedurat e Kuvendit, askujt nuk ju është mohuar e drejta e fjalës. Është bërë një punë e mrekullueshme dhe ju falenderoj secilin nga ju, po ashtu edhe stafin e Kuvendit të Komunës për angazhimin e tyre. Tani po e qesim në votim për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e proceduan për shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin dhe analizimin e 'Propozimit për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026'.

Pika e gjashtë (6) - Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'. Sqarimet u dhanë në fillim nga Drejtori për Shërbime Publike, andaj tani po e qesim në votim propozimin në fjalë.

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ridestinimit dhe rishpërndarjes së mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'.

Pika e shtatë (7) - Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.

Filloreta Musaj: E mbështesim për procedim dhe shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.

Laureat Gojnovci: Ne nuk jemi kundër ndërtimit të Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme, por kundër mënyrës së ardhjes në shqyrtim të këtij propozimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqë nuk kemi diskutime tjera, po e qesim në votim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.
U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme'.

Pika e tetë (8) - Të Ndryshme.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në qoftë se nuk ka dikush të shtojë ndonjë çështje te 'Të Ndryshme', konstatoj se është mbyllur mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:35 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani